

**STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PharmaBest Group” shpk**

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1) Sot, më 08.03.2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “PharmaBest Group” SHPK.
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:
 - a) Besmir Buba, atësia Bardhy, shtetas Shqipëtar, identifikuar me anë të pasaportës me numër 035723646, me numër personal identifikimi I81015042W i datëlindjes 15.10.1988, lindur në Berat dhe banues në Berat; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
 - b) Sanje Cepele, atësia Demir, shtetas Shqipëtar, identifikuar me anë të pasaportës me numër 035139453, me numër personal identifikimi G45418034O e datëlindjes 18.04.1964, lindur në Deshiras dhe banues në Fier; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 2
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - a) Import i pajisjeve mjekësore.
 - b) Tregëtim me shumicë i pajisjeve mjekësore.
 - c) Import i produkteve kozmetike dhe farmaceutike: shtesa ushqimore, vitamina.
 - d) Tregëtim me shumicë e pakicë i produkteve kozmetike dhe farmaceutike: shtesa ushqimore, vitamina.

**Neni 3
Kohëzgjatja**


- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga “Mujo Ulqinaku”, Lagja “15 tectori”, Zona Kadastrale 8533, Nr. Pasurisë 4/929+1-1, Fier.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përsaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Faqe 1 e 9

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
PharmaBest Group SHPK



KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestari shoqërisë është 10000 (Dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (Dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Besmir Buba, zotërues i 1 (Një) kuote me vlerë të përgjithshme 5000 (Pesë mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues Sanije Çepele, zotërues i 1 (Një) kuote me vlerë të përgjithshme 5000 (Pesë mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve në para të përcaktuara sa më sipër janë gjendje në arkën e shoqërisë.

Neni 6 Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

1. Administartori mund t'u kërkojë ortakevë të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre.
2. Ne rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaj një interes mbi shumën e papagur me një kamatvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.
3. Ne rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar Administrtatori mund t'ë njoftojë paraprakisht të paktën katërmëdhjetë ditë të plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributit, duke i kërkuar pagesen e kontributit të pashlyer dhe të kamatvonesës së llogaritur.
4. Nëse pagesa nuk kryhet Brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, mund te anulohet me vendim të administratorit dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividentët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluara dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
5. Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administrtatori e konsideron të përshtatshme.
6. Personi, kuota e të cilit është anular, humbet cilësine e ortakut në lidhje më këtë kuotë, por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anullimit të kuotës së bashku me kamatvonesën e llogritur për këto kontribute përpara anullimit të kuotës.

Neni 7 Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 Dt.14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë

Faqe 2 e 9

*Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
PharmaBest Group SHPK*

me shumicën e kualifikuar (tre të katertat) të votave të ortakeve, në përputhje me parashikimet e Nenit 87 të ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 .

Neni 8
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërise duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës.
2. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
3. Shoqeria mund të vendos zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Neni 9
Transferimi i kapitalit

- 1) Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 10
Organi Vendimmarrës

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatijet e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

Faqe 3 e 9

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

PharmaBest Group SHPK

- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
 - 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
 - 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

- 1) Administratoret thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe me kërkesën e ortakëve sipas nenit 84 të ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- 2) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike, përfshirë dhe zotëruesin e kuotave në zotërim të përbashkëet. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 3) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 2 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 12

Kuorumi

- 1) Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13

Marrja e vendimeve

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Faqe 4 e 9

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

PharmaBest Group SHPK

- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 14
Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 15
Administrimi

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Besmir Buba, atësia Bardhyl shtetas Shqipëtar, identifikuar me anë të pasaportës me numër 035723646, me numër personal identifikimi I81015042W i datelindjes 15.10.1988, lindur në Berat dhe banues në Berat, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.
- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjlltas.
- 4) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 16
Kompetencat e Administratorëve

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administratorit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeşen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatişin dhe nënskruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;



- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 17 Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që

Faqe 6 e 9

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
PharmaBest Group SHPK

rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 8) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkесë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 18 Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit/ëve

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

1. Personi nuk eshte me Administrator sipas parashikimeve te ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te ligjit.
2. Personi ndodhet ne gjendje paaftesia paguese.
3. Personi vuani ose mund te vuaj nga crrégullime mendore.
4. Personi jep doreheqjen nga detyra duke njofuar shoqerine.
5. Personi ka munguar per me shume se 6 muaj radhazi pa lejen e administratoreve te tjere ne mbledhjen e administratoreve te mbajtur gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjithshme me propozimin e Administratoreve vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 19 Shpérblimi, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e administratorit/ve

1. Administratori/ët shpérblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 te ligjit.
2. Asambleja e Përgjithshme mund te parashikojë përfitime, nëpërmjet shpérblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera për cdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose shoqëri paraardhëse të shoqerise ekzistuese ose te filaj leve te saj, ose per cdo familjar te tyre ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre dhe mund te paguaj kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.



Administratorit/eve mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesmarjen e tyre ne asamblene e administratoreve ose te komiteteteve te administratoreve ose te asamblese se per gjithshme ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

KREU IV VITI FINANCIAR, DIVIDENTËT DHE KALIMI I FITIMEVE

Neni 20 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 21 Dividentët

- 1) Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te ligjit, shoqeria me shumice te kualifikuar te votive se Asamblese Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkateze te ortakeve.
- 2) Dividendet deklarohen dhe paguhen ne perpjestim te drejte me shumat e paguara per kuotat.
- 3) Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbart interesa ndaj shoqerise.
- 4) Cdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet brenda dy mëngjesit vjetore nga data e maturimit, ne rast se vendoset me shumice te kualifikuar votash nga Asambleja e per gjithshme, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta paguaj ate.

Neni 22 Kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar

Administratoret pas vendimit te marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë te kualifikuar votash, dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 te ligjit, mund te vendosin te kalojnë në kapitalin themeltar te shoqërisë fitimet e pashpérndara te cilat nuk do te përdoren për te paguar dividend preferencial apo shuma te tjera te parashikuara për rezervat e kapitalit te shoqërisë.

KREU V PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 23 Prishja dhe likuidimi

- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund te behet ne çdo kohe:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;

Faqe 8 e 9
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
PharmaBest Group SHPK

- b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
 - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Ne ketë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër " .
 - 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
 - 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
 - 5) Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 24
Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."


Neni 25
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me ketë statut dhe dispozitat e legjislaçionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 26
Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njoitura nga ligji.

O R T A K È T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"PharmaBest Group" SHPK

Besimir Bube

 (Emër, Mbiemër, Nënshtrimi)

Hanjje Gopelë

 (Emër, Mbiemër, Nënshtrimi)

Faqe 9 e 9
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
PharmaBest Group SHPK

